



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1910, datë 30.04.2012

Për

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.

Këshilli Drejtues (*KD*) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*AKEP*), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 30.04.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimi i procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e Neofone sh.p.k me nr. nr 146 Prot, datë 22.03.2012 (nr. 558 Prot. i AKEP, datë 26.03.2012) “Për anulimin në mënyrë të njëanëshme të “facilitetit shoqëruese” të aksesit dhe interkoneksionit nga operatori FNT Albanian Mobile Communications Sh.a, si dhe për përcaktimin e tarifës së terminimit për thirrjet me origjinë ndërkombëtare”,
- Shkresa e Neofone sh.p.k me nr. 128. Prot datë 08.02.2012, “Përgjigje e shkresës suaj nr. 813.prot datë 07.02.2012 “Njoftim i tarifës së re për thirrjet hyrëse ndërkombëtare duke filluar nga data 15.02.2012”.
- Shkresa e Neofone sh.p.k me nr. 130. Prot datë 09.02.2012, “Përgjigje e shkresës suaj nr. 835. Prot datë 08.02.2012 “Njoftim i tarifës së re për thirrjet hyrëse ndërkombëtare për terminimin në rrjetin fix të AMC duke filluar nga data 16.02.2012” dhe shkresës suaj nr. 847. Prot datë 08.02.2012 “Njoftim dhe dërgim i amendimit mbi tarifën e reja të terminimit për trafikun hyrës ndërkombëtar në rrjetet fiks dhe mobile”.
- Shkresa e Neofone sh.p.k me nr. 136. Prot datë 20.02.2012, “Për anulimin e “Faciliteteve shoqëruese” të alokuara për Neofone Sh.p.k dhe ndërprerjen e shërbimit të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve me origjinë rrjetet ndërkombëtare”.
- Shkresa e Neofone sh.p.k me nr. 138. Prot datë 23.02.2012, “Për mos terminimin e thirrjeve të numrave të portuara nga rrjetet e tjera mobile në rrjetin AMC me origjinë rrjetet ndërkombëtare”.
- Shkresa e Neofone sh.p.k me nr. 144. Prot datë 12.03.2012, “Për moshapjen e shërbimit të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga shërbimi me kart[ë të parapaguar (OSHKP) dhe anulimin e “Facilitetit shoqëruesë” të alkoluara për Neofone sh.p.k.”

- AMC sh.a me shkresën nr. 813. Prot datë 07.02.2012, “Njoftim i tarifës së re hyrëse ndërkombëtare duke filluar nga data 15.02.2012”.
 - AMC sh.a me shkresën nr. 835. Prot datë 08.02.2012, “Njoftim i tarifës së re për thirrjet hyrëse ndërkombëtare për terminimin në rrjetin fix të AMC duke filluar nga data 16.02.2012”.
 - AMC sh.a me shkresën nr. 847. Prot datë 08.02.2012, “ Njoftimi dhe dërgimi i amendimit mbi tarifën e reja të terminimit për trafikun hyrës ndërkombëtar në rrjetet Fiks dhe Mobile”.
 - Korrespondencat me email e shkëmbyer midis palëve.
 - AMC sh.a., me shkresën nr. 2019/1. Prot datë 06.04.2012 (nr. 558/2. Prot. i AKEP datë 10.04.2012), “Kërkesë për shtyerje të seancës dëgjimore”.
 - Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
 - si dhe,
- duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. Neofone sh.p.k, me shkresën nr. 146 Prot, datë 22.03.2012 “Për anulimin në mënyrë të njëanshme të “facilitetit shoqëruese” të aksesit dhe interkoneksionit nga operatori FNT Albanian Mobile Communications Sh.a, si dhe për përcaktimin e tarifës së terminimit për thirrjet me origjinë ndërkombëtare”, sqaron se:
 1. Neofone ka aplikuar online për Autorizimin e Përgjithshëm dhe ka përbushur kushtet e aplikimit më datë 12.03.2012. Gjithashtu Neofone ka përbushur detyrimin për paraqitjen e kontratave dypalëshe origjinale me operatorët jashtë RSH në lidhje me alokimin e Kodit ISPC, dhe interkoneksion dy palësh me teknologjinë TDM. Neofone sh.p.k e fillon mosmarrëveshjen me AMC që në momentin e marrjes së letrës me nr. 813. Prot. datë 07.02.2012 “Njoftim i tarifës së re për thirrjet hyrëse ndërkombëtare duke filluar nga data 15.02.2012”, që njofton ndryshimin e njëanshëm të Tarifës së Interkoneksionit për thirrjet me origjinë ndërkombëtare drejt rrjetit AMC. Neofone kthen përgjigje me shkresën nr. 128. Prot datë 08.02.2012, dhe me anë të postës elektronike, ku kërkon zhvillimin e negociatave dy palëshe në zbatim të kuadrit rregullator.
 2. AMC kthen përgjigje me anë të postës elektronike duke konfirmuar një takim, i cili u mbajt në ambientet e AMC më datë 10 shkurt ora 13:00, nga ky takim palët nuk kanë rënë dakord për tarifën e terminimit për thirrjet ndërkombëtare në rrjetin e AMC. Palët nuk kanë arritur të negociojnë tarifën e dërguara nëpërmjet shkresave me nr. 813. Prot datë 07.02.2012 dhe nr. 847 datë 08.02.2012. Neofone nuk ka fimosur amendamentin e marrëveshjes së interkoneksionit të paraqitur nga AMC, për shkak se tarifa ishte 22.56 lek/min, vlerë e cila ishte gati trefishi i tarifës pararendëse 7.57 lek/min dhe gati pesëfishi i kostos reale të AMC përcaktuar nga metodologjia BULRAIC me vlerë 4.6 lek/min.

Më datë 15 shkurt 2012, operatori FNT AMC, në kundravajtje të plotë me cdo klauzolë të kuadrit rregullator, pa njoftim dhe në mënyrë të njëanëshme ka anuluar 29 kanale (CIC) të kapacitetit minimal 2 Mbps në shërbim të Neofone.

Në këto kushte Neofone i kishte mbetur vetëm 1 kanal nga 30 kanale e kapacitetit minimal prej 2 Mbps të alokuara, i lënë hapur dhe i restriktuar vetëm për numeracionin e Neofone, duke restriktuar edhe thirrjen e OSHKP. Neofone ka komunikuar nëpërmjet korrespondencës elektronike (e-mail) më datë 15 shkurt 2012, duke i bërë të ditur për ndërprerjen e aksesit dhe interkoneksionit për shërbimet në Marrëveshjen e Interkoneksionit midis palëve. AMC nuk kthen përgjigje, është e disata herë që nuk respekton kuadrin rregullator dhe shkel në mënyrë të pa precedent masat rregulatore të vendosura nga AKEP.

Operatori Neofone sh.p.k me shkresat nr. 136 Prot datë 20.02.2012, nr. 138. Prot datë 23.02.2012, dhe nr. 144. Prot datë 12.03.2012, njofton AMC “Për anulimin e “Faciliteteve Shoqëruese” të alokuara për Neofone sh.p.k dhe ndërprerjen e shërbimit të interkoneksionit për terminimin e thirjeve me origjinë rrjetet ndërkombëtare”. Operatori AMC nuk kthen përsëri përgjigje.

3. Në përgjigje të Nofone nuk ka pasur anjë reagim nga operatori AMC, duke injoruar plotësisht cdo praktik ligjore. Aktualisht operatori AMC vazhdon të mbajë të mbyllur qarqet e interkoneksionit me kapacitet minimal 2Mbps për Neofone duke lënë vetëm një kanal të hapur, i cili është i restriktuar në kundravajtje të plotë me marrëveshjen e interkoneksionit midis palëve.

Neofone sh.p.k shpjegon se, ka lidhur marrëveshje komerciale me operatorë të cilët operojnë jashtë Republikës së Shqipërisë, duke terminuar drejt AMC sh.a trafikun e gjeneruar nga këta operator në kuadër të liberalizimit të tregut dhe konkurrencës efektive në tregun shqiptar. Neofone në këtë mënyrë përmbush misionin e krijimit të konkurrencës efektive në tregun shqiptar për shërbimin e terminimit. Në këtë treg sipërrmarësi AMC maban statusin e OFNT.

Këto kosto të shkaktuara në mënyrë antiligjore nga AMC përbëjnë një dëm të konsiderueshëm financiar për Neofone sh.p.k. Neofone i kërkon AKEP-it të zgjidhë në mënyrë sa më urgjente mosmarrëveshjen midis Neofone sh.p.k dhe AMC sh.a, me qëllim që të minimizohen kostot e shkaktuara në mënyrë të padrejtë, abuzive dhe në kundërshtim me kuadrin rregullator si dhe sanksionimin e veprimeve antiligjore të operatorit AMC.

Në përfundim, Neofone i kërkon AKEP, që:

- Të zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje t’i referohet gjërësisht nenit 60 (Urdhëri i AKEP), neni 61 (Kontrolli i vecantë ndaj Sjelljeve Antikonkurruese), neni 120 (zgjidhja e Mosmarrëveshjeve), neni 135, neni 137 etj.
- Të specifikohet qartë kushtet e interkoneksionit midis Neofone sh.p.k dhe AMC, duke parandaluar dhe specifikuar qartë mos ndryshimin e aksesit për terminimin dhe facilitetet shoqëruese, praktike e cila ndiqet gjërësisht nga AMC duke limituar

numrin e kanaleve në facilitet dhe duke limituar qëllimin e përdorimit të faciliteteve dhe krijimin e barrierave artificiale në zhdukjen e konkurrencës.

- Të përcaktohen qartë modalitetet e interkoneksionit në mënyrë që të shmanget çdo keqinterpretim tjetër i mundshëm mes dy sipërmarrësve.
- Të urdhërojnë në mënyrë eksplicite (Urdhër i Posaçëm) hapjen urgjente të aksesit në facilitetet aktuale midis AMC dhe Neofone dhe anulimin e ndërprerjes së njëanëshme të tij për terminimin si për trafikun kombëtar ashtu edhe për atë ndërkombëtar për një shfrytëzim sa më eficient.
- Të përcaktojnë e Tarifën për Terminimin e Thirrjeve Ndërkombëtare në rrjetin AMC.

4. Më datat 10.4.2012 dhe 20.4.2012, me ftesë të AKEP, palët janë thirrur në seancë paraprake, por pala paditëse nuk u paraqit, si pasojë takimi nuk u realizua.
5. Sa më sipër, duke qënë se, sipërmarrësit Neofone sh.p.k. dhe AMC sh.a., megjithë përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord mbi tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e AMC sh.a., e si pasojë moslidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit, AKEP në zbatim të nenit 50 dhe në vijim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me iniciativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 te nenit 115, të Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 te nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.;
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
 - Altin Rrapaj Kryetar
 - Jonida Gjika Anëtar
 - Nuredin Hasanaj Anëtar
 - Esmeralda Dervishi Anëtar
 - Dritan Malaj Anëtar

3. Të njoftohen palët e interesuara Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a. për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE